

VI — Në *fjalë të urta* (gjithsejt rreth 900 sosh) është shprehur filozofia e jetës në këshillat që shërbejnë si formula, duke qenë rezultate të përvojës së madhe gjatë jetës së vështirë, të hidhur e plotë peripeti. Nga ato populli ynë ka nxjerrë mësim të çmueshme për situata të ndryshme të jetës. Në mënyrë konstruktive, të shkurtër e të përmbledhur janë thënë mendime të thella, që janë një akumulim i gjatë i përvojës jetësore dhe i mendjehollësisë së masës së paarsimuar.

Në gjashtë faqet e fundit të blenit autori është përpjekur ti' shpjegojë fjalët e panjohura — barbarizmat, lokalizmat e provincializmat. Në një faqe, ka dhënë disa hollësi biografike për tregimtarët popullorë nga të cilët i ka shënuar këto njësi folklorike, ndërsa në një faqe tjetër ka dhënë ca shpjegime gjuhësore rreth redak-

timit të këtij bleni, duke sjellë në fund edhe bibliografinë ndihmëse, që ka përdorur gjatë pregaditjes së këtij bleni.

Halil Kajtazi në mbarështrimin e e *Blenit PROZA POPULLORE E DRENICËS I*, nuk i është përmbajtur një kriteri rigoroz shkencor në ndarjen dhe klasifikimin e njësive folklorike në lloje të caktuara të prozës popullore. Ai nuk ka fiksuar kufij të prerë, ndaj ndodhë që t'i ngatërrojë tregimet me përralla e frazeologjizmat me fjalë të urta. Ai është prirur më tepër nga dashuria dhe vullneti për punë dhe duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të këtyre materialeve në pasurimin e kulturës shpirtërore të popullit tonë, ka treguar gjithsesi një punë vetëmohuese.

MEHMET HALIMI

Halil Kajtazi, PROZA POPULLORE E DRENICËS, II, Prishtinë 1972, f. 270

Është kjo një përmbledhje e prozës popullore që dallohet dukshëm nga përmbledhja *Proza popullore e Drenicës, I*, si nga aspekti sasior ashtu edhe nga aspekti cilësor. Njëkohësisht, ky ble dëshmon për një profesionalist të pasionuar në zgjedhjen e materialeve folklorike.

Bleni *Proza popullore e Drenicës, II*, ka 270 faqe. Libri hapet me një parathënie gjysëmfaqëshe, ku autori vë në spikamë qëllimin dhe rëndësinë që ka mbledhja e folklorit popullor. Pastaj vjen lista e tregimtarëve dhe e tregimeve që ata kanë dhënë. E tërë lënda është klasifikuar në pesë kapituj: *përralla, fabula, kallëzime, anekdota dhe fjalë të urta*. Në fund është fjalorthi i fjalëve të huaja dhe i fjalëve të rralla.

I — *Përrallat* përfshijnë 43 njësi. Disa nga këto janë shumë të gjata dhe kanë një ndërtim të përsosur kompozicional. Në to bie në sy fantazia shumë e zhvilluar e njerëzve të thjeshtë të popullit. Turma e gjerë ishte e shtypur gjatë shekujve nga sundues të ndryshëm, por ajo nuk është pajtuar kurrë me atë jetë të vështi-

rë, e me atë skamje të rëndë. Në mungesë të fuqisë për të përmbysur raportet shoqërore ekzistuese, njerëzit e thjeshtë kanë imagjinuar një botë dëshirash, një botë fantastike, ku spikaten vuajtjet, por dhe dëshirat e synimet e një shoqërie të caktuar. Kështu dëshirën për një jetë më të lehtë e të pamundimshme e gjejmë, për shembëll, në përrallën që bën fjalën për „dollapin magjik” nga i cili rrjedhin të gjitha të mirat për të ngrënë e për të pirë (fq. 12). Po këtë dëshirë e gjejmë nëpërmjet të motivit të metamorfozës (f. 13), ku lepuri shndërrohet në kulshedër, ndërsa një copë mish e thiut kthehet në bretkocë (f. 17-18), e bretkoca shndërrohet në një nuse të bukur (f. 20-21). Xhelozia, lakmia e rivaliteti vihen në pah në përrallën „Halla, kulshedra e jetimja”. Po kështu motivi i xhelozisë, i lakmisë ndaj pasurisë e ndjenjës së inferioritetit spikatet në përrallën „Zana e djali”, poashtu dhe fati i vajzës bonjake së cilës i vjen në ndihmë lopa Laruke (f. 14-15), etj. Bindjen e disa njerëzve në idenë se fati i njeriut është i caktuar dhe nuk ka fuqi që t'i kundërvihet e gjejmë në përra-

llën f. 80-81, njëkohësisht edhe bindjen që njeriu e ka të caktuar ushqimin e përditshëm jetësor „riskun” (f. 75-76). Mirëpo, nga ana tjetër, ai vetë e kundërshton më vonë këtë mendim, duke pohuar se koha shkon e nuk kthen më kurrë; ajo është faktor i pakompenzueshëm. Prandaj, duke pasur parasysh realitetin e hidhur (f. 30), duhet përpjekur gjithnjë për një jetë më të mirë.

Në një pjesë të mirë të këtyre përrallave dominon edhe dëshira dhe synimet për të zhdukur shoqërinë klasore, kur shprehet dëshira për t'u martuar me ndonjë femër të klasës së lartë (f. 31-33). Kuptimi i jetës së dy të rinjve dhe fuqia e dashurisë së tyre (f. 52-57) çmohen lart, duke u peshuar me një logjikë reale. Shikuar në tërësi, motivi kryesor i përrallave të këtij bleni është lufta në mes të së mirës e së keqes, në mes të së vërtetës e gënjeshtres, të drejtësisë e të padrejtësisë.

II — *Fabulat* janë prezentuar në 48 njësi, numër ky bukur i madh. Në këto fabula vërejmë zgjuarësinë natyrale e të lindur të fshatarëve analfabetë, të paarsimuar, të trevës së Drenicës. Në të gjitha fabulat përmes dialogut të insekteve, shpendëve e kafshëve vihen në thumb, në mënyrë alegorike, veset e njerëzve. Kështu për shembëll, në fabulën „Prisi” përqeshen njerëzit që fusin hundët gjithkund. Nuk duhet lakmuar gjëja e huaj, sepse e huaja nuk mund të bëhet e jotja (f. 101). Lidhja e miqësisë me të keqin të sjell të keqen në derë të shtëpisë (f. 102,103). Tradhëtia është cilësi e njerëzve të ligj (f. 104). Në dialogun në mes lisit e kungullit (f. 107) kritikohen njerëzit mendjehetë e mendjemëdhenj, që rriten e gufojnë shpejt pa ndonjë përvojë jetësore. Poashtu kritikohen dhe njerëzit, që hedhin gurin e fshehin dorën, ndërsa fajin e vet ua ngarkojnë të tjerëve (f.107). Në jetën e përditshme është e nevojshme ndihma reciproke, sepse e tërë shoqëria njerëzore qëndron në varësi reciproke të domosdoshme (f.108). Nga shtypja e dhuna, njerëzit me karakter të dobët e labil bëhen servilë (f.110), ndërsa e keqja e vogël rritet e bëhet e madhe, po nuk iu pre hovi me kohë (f.110). E keqja në jetë shpërblehet gjithmonë me të keq (f.112). Mosmi-

rënjojta gjithnjë ndërshkohet (f.116 — 117). Poashtu thumbohet kokëtrashësia (f.123) dhe egoizmi (f.124). Të gjitha fabulat e këtij bleni përshkohen nga karakteri edukativ. Në të gjejmë këshilla shumë të dobishme për jetën.

III — *Kallëzime* (gjithsejt 27 sosh). Në to paraqiten fragmente nga jeta reale, nga jeta e përditshme e popullit, nga situatat e ndryshme jetësore. Në ndonjërin kallëzim vihet në thumb shoqëria dhe pushteti i korruptuar turk (f. 149-152). Në disa të tjera vlerësohet lartë harmonia, rrespekti dhe vetëdija e plotë e varësisë reciproke (f. 158) dhe këshillat e pleqve që kanë një përvojë të gjatë jetësore (f.160 — 162). Njerëzit duhet të jenë të prirur të bëjnë vepra të mira, sepse triumfi i së drejtës dhe i së vërtetës është i domosdoshëm (f.168-173).

Në këtë kapitull ndeshim edhe në disa pleqnime, ku shquhet edhe mendjehollësia e femrës shqiptare, e cila është e aftë të peshojë me logjikë të shëndoshë, e të zgjidhë në mënyrë fatlume probleme të kapërthyera shoqërore (f.187).

IV — *Anekdotat* ka më së shumti, 107 sosh, gjë që dëshmon se kjo trevë është shumë e pasur me këtë lloj të prozës popullore.

Këto anekdota, të lindura nga realiteti jetësor kanë për protagonistë persona të caktuar, të shumtën e rasteve të njohur nga rrethi shoqëror, si: Tahir Paliqi, Kamer Kuka, Mulla Jonuzi i Suhodollit, Rexhep Halili i Vitakut, Adem aga i Bellaçevcit, Tahir Velia i Likoshanit, Xhemajl Obrija, Ramadan Shabani, etj. Këta pleqnarë në bisedat e tyre të përditshme apo edhe në pleqnime kanë krijuar anekdota të shumta, që janë margaritarë të prozës popullore. Në to thumbohen llafazanët (f. 195), pispillosja e tepruar e njerëzve megalomanë (f. 195), njerëzit që zënë vendin e pamërituar në shoqëri (f. 195). Kritikohet poashtu padrejtësia e kadilerëve dhe pushteti i korruptuar turk, ndërsa nga ana tjetër, vihet në pah zgjuarësia e lindur natyrore e popullit (f. 212), burrëria, durimi, maturia dhe zemërgjersia e shqiptarit (f. 215). Njeriu në jetë nuk duhet ta bëjë shprehi të keqen, sepse vështirë mund

të kthehet prapa në rrugën e mbarë të njerëzisë, sepse „çka piqet nuk hiqet” (f. 219).

Të gjitha anekdotat e këtij bleni shquhen për shkurtësinë e tyre, për gjuhën e pastër e stilin konciz ezo-pik. Në epiqendër të tyre përmbajnë ngjarje të jetës reale. Personazhet e vendi i ngjarjes janë autoktonë burimorë, nga treva e Drenicës. Anekdotat të bartura ka shumë pak, kryesisht ato që lidhen për personazhin e Nasradin Hoxhës.

V — Në *fjalët e urta*, (gjithsej 370 sosh) shprehet ajo përvojë jetësore, e sprovuar disa herë gjatë periudhave të kaluara historike. Në të, në mënyrë të shkurtër, paraqiten dy komponente jetësore — *të përjetuarit në të kalurën e hidhur dhe këshilla dedikuar gjeneratave që pasojnë*. Po veçojmë disa nga fjalët e urta të këtij bleni që, sipas mendimit tonë, janë shumë të fuqishme. Punët nuk shkojnë mbarë aty ku punohet pas shpine e me dredhi: *Bukt simite nuk vinë ku â kaca me rasoj*. Njerëzit e nder-

shëm kanë turp e njerëzi: *Çëlsi i burrisë â marrja*. Sentencën e Naim Frashërit „Ti hiq pas kohës, koha s' vjen pas teje” e përfill edhe populli — *Duhet me konë plak, po me mën t'reja*, do të thotë duhet ecur me kohën dhe progresin shoqëror. Të mirat e harmonia i japin njeriut vullnet për jetë — *Fjala e mirë jetën ta zgjatë*. Në ndonjerën nga këto lartësohet zemërgjerësia — *Nuk â trim aj qi vret, po aj qi falë*, e shumë të tjera fjalë të urta kësisoji.

Në këto fjalë të urta spikatet, pos mendjehollësisë, zgjuarësisë e përvojës së popullit, edhe etika e shoqërisë shqiptare. Populli ynë ka krijuar norma të caktuara shoqërore, që janë bërë traditë, edhepse të pashkruara. Ai u është përmbajtur atyre normave në të kaluarën e gjer më sot.

Bleni *Proza popullore e Drenicës, II*, është paraqitur në trajtë mjaft voluminoze, duke qenë mjaft kualitative për nga zgjedhja e njësive të llojeve të ndryshme të prozës popullore.

MEHMET HALIMI

Halil Kajtazi, NGA LIRIKA POPULLORE E DRENICËS, Prishtinë 1972, f. 202

Ky ble ka 202 faqe, në të cilat përfshihen 138 këngë lirike, të ndara në gjashtë kapituj. Libri fillon me një parathënie, ku H. Kajtazi flet mbi rëndësinë e folklorit dhe vështirësitë që ka ndeshur, duke mbledhur këto këngë. Pas parathënies, autori i kësaj përmbledhjeje, në tetë faqe, ka bërë një vështrim të shkurtër, duke dhënë shpjegime dhe komente për këngët e secilit kapitull, veçanërisht ka komentuar më hollësisht këngët e dasmës dhe këngët shpotitëse.

Në kapitullin I janë radhitur këngët *Nina-nana* në të cilat, nëna me dashuri të sinçertë amnore i këndon foshnjës së vet. Duke e përkundur në ritmin e melodisë së djepit, ajo njëherazi e shoqëron edhe me këngë, në të cilat shpreh idealin estetik të kohës që i përgjigjet ambientit ku jeton edhe vetë. Uron që t'i bëhet djali: „çoban me dhen e me dhi”, e ta martojë „me 'i qin krushk”, që ta mbathë e ta veshë sipas shijes së

fshatarit malësor, që të rritet e të bëhet „mahallë” e „me vllazni shumë”, e të tjera.

Në këto ninulla vërehet një ideal pak i vjetëruar që është tipik për nënat sot të shkuara në moshë, sepse nëna më e re, sot, të birin a të bijën dëshiron ta shohë në rrugën e dijes, të kulturës dhe të civilizimit, ta shoh të birin në institucione të ndryshme shkollore e shtetërore.

Ky cikël ninullash është i mangët nga dy aspekte: nga një anë numri i këngëve të prezentuara është i vogël, e nga ana tjetër ndihet edhe mungesa e ninullave bashkëkohore si dhe prania e këngëve për foshnjat e të dy gjinive, për djalin dhe vajzën.

II — Në *këngë dhe lojna fëmijësh*, të mbledhura me kujdes të posaçëm, pasqyrohet bota shpirtërore e fëmijëve, horizonti i tyre dijtunor për natyrën, objektet dhe shtazët shtëpiake. Karakteri shpotitës sheh humori